



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:261701

Datë: 28.09.2021

Numri i dokumentit: 02220002

A.nr. 1015/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçi dhe zyrtaren ligjore Edona Grajçevci, në konfliktin administrativ të paditësit Shoqëria “E.I.” Sh.p.k. me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sh.U., avokat nga Prishtina kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson Burim Shehu si dhe kundër të paditurës së dytë Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit të të paditurës së parë OSHP me numër PSH.nr.93/16 të datës 24.05.2016 si dhe kërkesën për kompenzimin e dëmit dhe fitimin e humbur, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 02.09.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit Shoqëria “E.I.” Sh.p.k. me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sh.U., avokat nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi PSH.nr.93/16 të datës 24.05.2016 i Organit Shqyrtues të Prokurimit si dhe kompenzimin e dëmit dhe fitimin e humbur.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike u mbajt konform nenit 41 të LKA-së, me praninë e palës paditëse, palëve të paditura si dhe ekspertit gjyqësor nga lëmia financiare F.B.

Paditësi me padinë e datës 04.07.2016, pohon se duke qenë i pakënaqur me njoftimin për kontratë të Autoritetit Kontraktues KEK Sh.A. kishte parashtruar ankesë në OSHP, pra tek e paditura e parë, me ç’rast e paditura e parë OSHP kishte marrë aktvendim me të cilin kishte aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit. Në lidhje me këtë, paditësi pohon se dispozitivi i këtij vendimi është në kundërtënie me vetveten dhe me kuptimin e përgjithshëm të atij vendimi, me arsyetimin e tij dhe me faktet vendimtare të theksuara në të e me provat dhe shkresat e

dosjes së tenderit. Kështu, vendimin e atakuar e cilëson si të paqartë konfuz dhe të pazbatueshëm. Poashtu shton se ky vendim nuk jep kurfarë udhëzimet konkrete detyruese për AK-KEK.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditësit, deklaroi: *“Mbetemi në tersi pranë padisë dhe kërkesë padisë si dhe te gjitha pretendimeve te cekura ne te njëjtën si dhe theksimeve deri te tanishme konkretisht pran precizimit të kërkesëpadisë komfor ekspertizës financiare 03.08.2021 bazuar ne provat e prezantuara ne padi si dhe ekspertizën financiare kërkojmë nga gjykata që e njëjta te aprovohet si ne precizimin e theksuar e gjithë kjo ne kuptim te nenit 26 alineja te LKA, respektivisht kompensimit, fitimit te humbur si ne precizim”.*

Më tutje, përfaqësuesi i paditësit rideklaroi: *“I kundërshtojmë ne teresi pretendimet e te paditurve konkretisht pretendimet e përfaqësuesit te OSHP me vet faktin s e vendimin e lëshuar nga i njëjti te cilin edhe e kemi kundërshtuar ka qenë i pa kuptuar me vet faktin se derisa ne piken 1 thuhet “ aprovohet”, ne piken 2 thuhet “vërtetohet”, jep me kuptua një vendim i tillë është i kundërligjshëm, andaj bazuar në të gjitha provat e prezantuara gjykatës si dhe kërkesat e paditësit edhe ne momentin e njoftimit te tenderit si dhe sqarimeve te tyre ne procesverbale, e ekspertiza te vajrave ne konsiderojmë se kërkesë padia është ne tersi e bazuar dhe si te tillë kërkojmë qe e njëjta te aprovohet”.*

Në fjalën përfundimtare, ndërkaq, përfaqësuesi i paditësit deklaroi: *“Duke u bazuar ne provat e administruara dhe theksimeve si ne seancat e kaluara dhe ne precizimin e padisë sipas parashtrësës se dërguar 03.08.2021, si dhe provës materiale ekspertizës i propozojmë gjykatës qe kërkesë padinë ta aprovoj ne tersi si te bazuar si dhe shpenzimet procedurale dhe ate per padi, shpenzimet e ekspertit , precizimin e kërkesë padisë për seancat e shtyra dhe ato te mbajtura ne shumen prej 1376 Euro”.*

I padituri i parë Organi Shqyrtues i Prokurimit, me përgjigjjen në padi të datës 24.04.2017 deklaroi se: *“Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të Komisionit vlerësues të AK-së, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesve të ankesave, konstatimeve, analizën konkrete dhe rekomandimin e ekspertit shqyrtues të cekur në ekspertizë, parashtrësave të OE ankues, parashtrësës së AK-së, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, ka konstatuar se nuk qëndron pretendimi ankimor i OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk është në listën e “VOITH” edhe eksperti shqyrtues në raportin e tij të ekspertizës por edhe gjatë seancës dëgjimore u konfirmua se nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit kjo vlen për Lot 1 pjesa 1 dhe 2. Lidhur me pretendimet për LOT 1 pjesa 3 poashtu nuk qëndron pretendimi ankimor sepse OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me “ISO VG” ashtu siç është kërkuar në specifikimin teknik. Paneli shqyrtues nuk ka vërtetuar se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së lidhur me pjesën 4 dhe 5 të këtij LOTI. Paneli shqyrtues ka konfirmuar se nuk qëndrojnë pretendimet e OE ankues lidhur me shkeljet e dispozitave të nenit 56, 59 dhe 60 të LPP-së, kështu paneli shqyrtues konstatoi se autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka respektuar dispozitat e nenit 56, 59, 60 të LPP-së dhe ia fali besimin ekspertit teknik”.*

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i të paditurit të parë deklaroi: *“Mbesim në tersi pran përgjigjes në padi si dhe vendimit te OSHP, te atakuar në ketë padi si dhe deklarimeve ne seancat paraprake. I kundërshtojmë në tersi pretendimet e palës paditëse sepse ky aktivitet i*

prokurimit është ne harmoni me dispozitat ligjore te nenit 56, 59,dhe 60 te LPP si dhe e kundërshtojmë ne tersi raportin e ekspertizës financiare sepse e njëjta është nxjerr me pretendimet sepse paditësi do te ishte fitues i këtij tenderi.

Sa i përket kërkesës për fitim te humbur neni 119 i LPP nuk e obligon OSHP që të bej kompensimin e demit te humbur”.

Në fjalën përfundimtare, ndërkaq, përfaqësuesi i të paditurit të parë deklaroi: *“I kundërshtojmë ne tersi pretendimet e palës paditëse, si dhe i propozojmë gjykatës qe pas administrimit te provave si ne shkresa te lëndës qe panin dhe kërkesë padinë e paditësit ta refuzoj si te pa bazuar dhe ta le ne fuqi vendimin e OSHP, PSH.nr.93/16 te dt. 02.05.2016”.*

Me përgjigjen në padi e paditura e dytë KEK Sh.A. të datës 23.02.2021 deklaroi: *“Duke pasur parasysh se kriter themelor i shpërblimit me kontratë për aktivitetin e prokurimit KEKO-15/121/111 ka qenë çmimi më i ulët për operatorin përgjegjës, atëherë lehtësisht mund të vijmë në përfundim se projekti i prokurimit ishte kryer konform LPP 04/I-042 dhe ligjeve për ploëtsim ndryshimin e tij dhe oferta fituese ishte për OE me çmimin më të lirë. Shton se nga padia e paditësit mund të konstatohet se nuk ka prova të mjaftueshme dhe nuk ekziston asnjë fakt në bazë të së cilit mund të kërkohet anulimi i vendimit dhe as baza ligjore për shpërblimin e demit. Të gjitha pretendimeve të paditësit sipas ankesës, OSHP i ka dhënë sqarimet adekuate dhe ka vendosur për to meritorisht. Poashtu shton se nxjerrja e vendimit është bërë bazuar në ekspertizën e ekspertit të OSHP-së”.*

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i të paditurit të dytë KEK Sh.A. deklaroi: *“Edhe me tej qëndrojmë pranë përgjigjes në padi dhe deklarimeve te seancave të kaluara duke e kundërshtuar padinë dhe kërkesë padinë ne tersi si te pa bazuar. Kjo argumentohet edhe me provat relevante te cilat gjenden ne shkresa te lendes dhe nuk ka as ndonjë arsye ligjore per anulimin e vendimit te OSHP.*

Sa i përket ekspertizës financiare te ekspertit F.B. te njëjtën e kundërshtojmë ne tersi pasi qe kjo ekspertizë nuk mbështetet ne prova materiale, dhe nga shkresat e lendes shihet qartë se për dhënien e kontratës ka qenë kriteri me i lire dhe operatori i përgjegjshëm dhe nuk qëndroj pretendimet e palës paditëse lidhur me kualitetin me te mire te vajrave”.

I autorizuari i të paditurës e dytë e pyet ekspertin nga lëmia financiare *“se ku i ka siguruar të dhënat sipas viteve 2016,2017, 2018 si dhe si ka ardhur në përfundim të shumës 174,038.23?”.*

Ekspert nga lëmia financiare përgjigjet: *“Unë te dhënat qe i kam cek ne ekspertize janë te bazuara në kontratën 1305te nënshkruar ne mes KEK dhe operatorit fitues si dhe faturave te cilat janë realizuar meqenëse tenderi ka qenë për 3 vjet mirëpo është realizuar për 4 vite, 2016 deri 2019. Vlera e faturave me te cilat e ka dërguar operatori fitues B.P. për vitin 2016 kapin shumen 211,967.54. Për vitin 2017 vlera e mallrave ka qene 320,229.78, për vitin 2018 vlerave e mallrave ka qen 275,022.95, për vitin 2019 vlera e mallrave ka qenë 366,817.96”.*

Në fjalën përfundimtare, ndërkaq, përfaqësuesi i të paditurit të dytë deklaroi: *“Bazuar ne deklarimet dhe provat te cilat gjenden ne shkresa te lendes konsiderojmë se gjykatës i kemi ofruar dëshmi te mjaftueshme qe padinë dhe precizimin e kërkesë padis ta refuzoj ne tersi si te*

pa bazuar pasi që me asnjë prove ligjore nuk ka arsye për anulimin e vendimit të OSHP, dhe gjithçka është e kuart dhe transparente dhe ne bazë të procedurave të dosjes së tenderit nuk ka kurrfarë shkelje procedurale apo ligjore, andaj edhe ne bazë të raportit të ekspertit shqyrtues është nxjerr edhe vendimi i OSHP. Mbi provat dhe faktet që janë në shkresa të lendes kërkoj nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë ta refuzoj si të pa bazuar, shpenzime e procedurës ne nuk i kërkojmë”.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: ankesa nr.93/16 i dt.08.04.2016, procesverbal i mbi shqyrtimit kryesor nën shenjë PSH.Nr.93/16 i dt.24.05.2016, vendimi i OSHP nën shenjë PSH.nr.93/16 i dt.24.05.2016, shkresa Power transsmision oils for voith turbo trans missions [pa datë], shkresa me titull specifika teknike për vajrat dhe yndyrat industriale [pa datë], formulari i dorëzimit të tenderit i dt. 19.11.2015, përshkrimi i çmimeve [pa datë], shkresa me titull “*mospajtimi ynë lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues të dhen si raport që na është përcjell me date 04.05.2016 me email*”, dt.06.05.2016, akti përcjellës i OSHP, me nr.93/16 i dt.01.05.2016, e-maili në emër të OSHP, i dt.04.05.2016, komplet dosja e tenderit me nr. të prokurimit: KEKO 15 121 111 e dt.08.10.2015 si dhe ekspertiza financiare e prokurimit e dt.30.07.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar.

Gjykata gjeti se Vendimi i kontestuar nga ana e paditësit është marrë konform të gjitha dispozitave procedurale dhe ligjore në fuqi dhe se i njëjti në asnjë rrethanë nuk përmban as shkelje esenciale të dispozitave procedurale, as vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e as zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale.

Gjykata erdhi në përfundim se vendimi i kontestuar i të paditurit të parë OSHP në mënyrë të qartë ka përshkruar dhe vlerësuar veçanërisht aspektin formal e procedural që është zhvilluar përgjatë gjithë trajtimit të çështjes administrative të paditësit. Në mënyrë të veçantë, pala e paditur në vendimin e kontestuar nga ana e paditësit ka trajtuar dhe arsyetuar faktet dhe rrethanat si dhe bazën ligjore e materiale mbi të cilën ka vendosur. Në këtë drejtim, gjykata mbështeti të paditurën në ndërlidhje me arsyet e refuzimit të pretendimeve ankimore të paditësit gjatë procedurës administrative. Në lidhje me këtë, Gjykata ju referua nenit 59 të LPP-së në të cilin përcaktohet: “**Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave 1. Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes: 1.1. së pari, vlerësimi të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji; 40 1.2. së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji. 2. Në rastin e procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara pas publikimit të njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues do t’i zgjedhë kandidatët që do të ftohen për të dorëzuar tender**

ose propozim, vetëm në bazë të: 2.1 kriterëve të përzgjedhjes të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit në përputhshmëri me paragrafin 2. të nenit 51 të këtij ligji dhe 2.2 dokumenteve, informatave dhe/ose dëshmime mbi kualifikimet e dorëzuara nga kandidatët si përgjigje të drejtpërdrejt ndaj kërkesave të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet parakualifikuese. Kandidatët që nuk zgjidhen në këtë mënyrë eliminohen nga pjesëmarrja e mëtutjeshme. Të gjithë kandidatët të cilët konstatohet se i plotësojnë kriteret e specifikuar dhe të cilët nuk janë përjashtuar sipas këtij paragrafi, do të ftohen që të dorëzojnë tender, përveç nëse numri i këtyre kandidatëve tejkalon numrin gjashtë (6). Nëse numri i kandidatëve tejkalon numrin gjashtë (6) atëherë autoriteti kontraktues do të ftojë vetëm gjashtë kandidatët më të kualifikuar që të dorëzojnë tender. KRPP në rregullat e prokurimit publik do të vendosë një procedurë detale që autoritetet kontraktuese duhet ta respektojnë gjatë përzgjedhjes në fjalë. KRPP do të sigurojë që procedura e tillë është: (i) në përputhshmëri me praktikën më të mira ndërkombëtare, (ii) siguron konkurrencë dhe transparencë adekuate, (iii) i zbaton parimin e mos-diskriminimit, dhe (iv) dhe përndryshe është në përputhshmëri me dispozitat aplikative të këtij ligji. 3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara, pas publikimit të njoftimit të kontratës, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

Në vijimësi të kësaj, gjykata ju referua edhe nenit 59 të LPP-së në të cilin përcaktohet: “Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve 1. Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. 2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. 3. Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve. Autoriteti kontraktues menjëherë do t'i dërgojë të gjithë tenderueseve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla. 4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. 5. Përveç komunikimeve që janë autorizuar saktësisht nga nenet 34, 35 të këtij ligji dhe paragrafi 2. dhe 3. i këtij neni, asnjë komunikim, diskutim ose negociatë e çfarëdo lloji nuk mund të mbahen ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një operatori ekonomik, në lidhje me një tender të dorëzuar”.

Së fundi, Gjykata ju referua edhe nenit 60 të LPP-së në të cilin përcaktohet: *“Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës 1. Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji. 2. Nëse autoriteti kontraktues ka përcaktuar në dosjen e tenderit se kontrata publike do ti jepet operatorit ekonomik që dorëzon tenderin e përgjegjshëm ekonomikisht më të favorshëm, dhënia e kësaj kontrate do të bëhet vetëm në bazë të kriterëve dhe peshës së tyre përkatëse të përcaktuar në dosjen e tenderit në pajtim me paragrafët 2. dhe 3. të nenit 52 të këtij ligji”.*

Në këtë drejtim, gjykata gjeti se e paditura e parë drejtë ka zbatuar procedurën administrative, me rastin e shqyrtimit të ankesës së paditësit, ka caktuar ekspertin në përputhje me nenin 113 të LPP-së, pas mendimit të së cilit dhe sipas pikëpamjes së të cili edhe e paditura e dytë ka marrë vendimin e kontestuar nga paditësi. Gjykata poashtu gjeti se e paditura e dytë drejt ka zbatuar nenin 56 të LPP-së duke aplikuar dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave, pastaj drejtë ka zbatuar nenin 59 të LPP-së duke ekzaminuar, vlerësuar dhe krahasuar tenderët, poashtu drejtë ka zbatuar nenin 60 të LPP-së duke vlerësuar dhe analizuar drejtë operatorët e përgjegjshëm dhe çmimin më të ulët të prezantuar nga ana e tyre e për të ardhur në përfundim me vendimin e atakuar nga paditësi.

Gjykata gjeti se paditësi as me padi dhe as gjatë seancës së shqyrtimit kryesor nuk arriti të jap prova dhe as të sqaroj se në çfarë drejtimi dhe vëllimi konsideron se ekziston shkelje e nenit 56, 59 dhe 60 e LPP-së.

Gjykata gjeti se i paditurat i parë me vendimin e atakuar, në mënyrë të qartë i ka sqaruar të gjitha pretendimet ankimore të paditësit dhe të njëjtat i vërtetoi edhe kjo Gjykatë se lidhur me pretendimet për LOT 1 pjesa 3 nuk qëndron pretendimi ankimor për fakti që Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me “I.V.” ashtu siç edhe është kërkuar në specifikimin teknik. Gjykata poashtu vërtetoi se nuk qëndrojnë as pretendimet e paditësit lidhur me LOT 1 pjesa 6 sepse OE i rekomanduar për kontratë ka aplikuar me vaj të transimisionit të kualitetit API GL-5 por që ka pasur mundësinë edhe me API GL-4. Në këtë drejtim gjykata vlerësoi se gjendja faktike nga dy të paditurat është vërtetuar në mënyrë të saktë e kjo vërtetohet edhe nga ekspertiza e ekspertit teknik në kuadër të OSHP-së me numër Nr.93/16 i datës 01.05.2016.

Gjykata erdhi në përfundim se paditësi, njëjtë sikurse edhe pjesëmarrësit tjerë në aktivitetin e prokurimit në fjalë, ishin trajtuar nga e paditura në pajtueshmëri të plotë me nenin 7 [Barazia në Trajtim/Jo-diskriminim], nenin 52 [Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës], si dhe të LPP-së nenin 60 [Kriteret për dhënien e kontratës].

Duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerësoi se vendimi i goditur me padi është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike e juridike.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditësit, por të njejtat i vlerësoi si të pa bazuara, ngase të njejtat nuk i ka provuar me asnjë provë të vetme, as para të paditurës e as me padinë e ushtruar në këtë Gjykatë.

Prandaj, gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, e paditura drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, kur ka marrë vendimin e kontestuar nga paditësi. Mbi këto arsye thëniet e paditëses në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46, paragrafit 2, lidhur me nenin 5, 6 dhe 38 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr. 1015/16, datë 02.09.2021

G j y q t a r i

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.